Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Admnistrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr.350/02-0051312/18 dt.02.03.2018, të pronarëve, Feti, Haki dhe Isa Selmani nga Prishtina, rr. 'Bashkim Fehmiu', H 1, nr.27, Lagjja 'Arbëria', në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e katër shtëpive individuale të banimit, në kuadër të Bllokut urban F-04 të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024 në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 24.04.2018, merr këtë:

# VENDIM
## PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I Caktohen kushtet ndërtimore** pronarëve Feti, Haki dhe Isa Selmani nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr.350/02-0051312/18 dt.02.03.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e katër shtëpive individuale të banimit, në kuadër të bllokut urban F-04, të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024 në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 110-3 dhe 155-19 ZK Sofali.

**II. Lokacioni** i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të:

Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim "Banim individual i ulët".

Pronari me 'Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024', me referencë nr.1205 dt. 15.11.217, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës, përmes sistemit online, është informuar me kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
  - nr. 110-3, me S=1507.0 m², me pronar Feti, Haki dhe Isa Selmani, "Arë e klasës 4";
  - nr. 155-19, me S=968.0 m², me pronar Feti Selmani, "Arë e klasës 4";
  
  Sipërfaqja totale S=2475m².
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në certifikatën e njësisë kadastrale, parcelat kadastrale nr.110-3 dhe 155-19 janë toka bujqësore të klasës 4;
- Në kuadër të parcelave kadastrale, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

02-05-2018
182

- Terreni ka pjerrtësi të vogël në drejtimin veri-perëndimor;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale është përmes rrugës ekzistuese dhe të planifikuar;
- Parcela kadastrale e lartcekur shtrihet në bllokun urban "F-04" dhe pjesërisht në rrugë të planifikuar të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore, dhe ndërtesa tjera kryesisht ndërtime të ulta.

IV. **Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin shtëpive individuale të banimit, në kuadër të bllokut urban "F-04", të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcela kadastrale e trajtuar për realizimin e shtëpive individuale të banimit, konkretisht parcelat kadastrale të përfshira-të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:
  - nr.110-3, me S=1012.37 m²;
  - nr.155-19, me S=957.0 m²;
  - nr.118-0, me S=143.0 m² (Pasuri shoqërore, sipërfaqja që propozohet të këmbehet)

  **Sipërfaqe totale S=2112.37m²;**
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e shtëpisë individuale të banimit / ndërtesës afariste / shtëpisë me destinim të përzier, konkretisht parcelat kadastrale të përfshira-të trajtuara jashtë vijës rregulluese, janë:
  - nr.110-3, me S=494.63 m²;
  - nr.155-19, me S=11.0 m²;

  **Sipërfaqe totale S=505.63m²;**
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas planit rregullues, të jetë për "banim individual", me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira për parking, etj. *(sipas projektit konceptual të prezantuar)*;
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas planit rregullues, është P+2, kurse i propozuar dhe i miratuar është B+P+1;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhesës ose suteren, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, është max. 30%;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, është max. 50%, ndërsa pjesa e bodrumit që del jashtë gabaritit të objektit në përdhesë nuk duhet të jetë mbi nivelin e tokës;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, është min. 50%;
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" 2016-2024, është max. 50%. Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: ***100%*** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi ***51%*** mbi tokë-suteren, dhe ***0%*** për etazhet e nëntokës-bodrume;
- Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës, për kthina primare min 0.5 H, për kthina sekondare min.0.2 H, dhe marrëveshja me fqiun deri në bashkim të plotë,
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit efiçient të energjisë,



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;

- Kuota e përdhesës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e niviletës së rrugës publike nga e cila ka qasje parcela, gjegjësisht në krahasim me kuotën zero;
- Kuota e përdhesës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se kuota e niveletës së rrugës publike,
- Kati përdhesë i ndërtesës, për tu konsideruar kat i plotë, duhet të jetë së paku 1,4 m mbi sipërfaqen tokësore, duhet të ketë së paku 2/3 të sipërfaqes së vet në lartësi minimale prej 2,3 m;
- Qasja në parcelë të jetë nga rruga e planifikuar e planit rregullues, të paraqitur në Planin e situacionit - "zgjidhjen urbane" të parcelës;
- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vendparkim, për një njësi banimi; Parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke e marrë parasysh kushtin prej 50% për gjelbërim;
- Në paraqitjen e situacionit të parcelës kadastrale, të paraqiten edhe organizimi i vendparkimeve të jashtme, rrugëve përreth parcelës, gjelbrimit të planifikuar, etj.;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efiçiencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

**V. Këmbimi** i pjesëve të parcelave kadastrale, nr. 110-3, dhe 118-0 ZK Sofali, do të bëhet sipas Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" dhe manualit të këmbimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar, me qëllim të shfrytëzimit të pjesës së parcelës nr.110-3, në pronësi private, për rrugë të planifikuar sipas Planit në fuqi, dhe këmbimit të kësaj pjese, me pjesën e parcelës 118-0, në pronësi "Pasuri Shoqërore", dhe shtrihet në mes të dy parcelave për të cilat po caktohen këto kushte ndërtimore..

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për këmbimin e pjesëve të parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit - "Zgjidhjes urbane" dhe manualit të këmbimit të parcelave, të bashkangjitura në këtë Vendim, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral të këtyre ndryshimeve, si dhe për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarëve të parcelave kadastrale, dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës. Procedura e këmbimit të parcelave të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar edhe në Planin e situacionit - "zgjidhjen urbane" dhe manualin e këmbimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VI. Ndarja dhe bashkimi**, i parcelave kadastrale nr.110-3 dhe 155-19 ZK Sofali, do të realizohet sipas parcelave ndërtimore, të përcaktuar sipas propozimit të kërkuesit dhe miratimit nga kjo drejtori, bazuar në Planin e situacionit - "zgjidhjes urbane" dhe manualin e ndarjes dhe bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" dhe manualit të ndarjes dhe bashkimit.

Procedura e ndarjes dhe bashkimit të do të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas përfundimit të procedurës së këmbimit, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar në Planin e situacionit- "zgjidhjen urbane" dhe manualin e bashkimit dhe ndarjes së parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

VII. <u>Kyçja në infrastrukturë</u> - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VIII. <u>Dokumentacioni ndërtimor</u> - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, <u>relative dhe absolute</u>;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, <u>relative dhe absolute</u>;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensonale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

**IX. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcelat kadastrale nr. 110-3 dhe 155-19 ZK Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, "arë e klasës 4", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – "zgjidhjes urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=2475m^2$, procedurë kjo e cila duhet të përfundohet pas realizimit të pikave V dhe VI, të këtij Vendimi. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

X. **Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

XI. **Pagesa e taksës** administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 - 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XII. **Vlefshmëria** e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## Arsyetim

Pronarët, Feti, Haki dhe Isa Selmani nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02 – 0051312/18 dt.02.03.2018, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e katër shtëpive individuale të banimit, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronarët kanë prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale nr.110-3 dhe 155-19, ZK Sofali, evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914066-00110-3 dhe P-71914066-00155-19, ZK Sofali;
- Informimi nga Plani Rregullues i Hollesishem "Sofali" 2016-2024 me referencë 1205, dt.15.11.2017, lëshuar përmes sistemit online nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të qëndrueshëm, Komuna e Prishtinës;
- Incizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Sharr Pllana, nga Prishtina, me numër të licencës 119;
- Manualin me propozim për këmbimin e pjesëve të parcelave, punuar nga gjeodeti i licensuar Veli Hyseni, nga Prishtina, me numër të licensës 85;



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Manualin me propozim për ndarje dhe bashkim të pjesëve të parcelave, punuar nga gjeodeti i licensuar Musafer Mustafa, me numër të licensës 9;
- Projektin konceptual për parcelat kadastrale në fjalë, të hartuar nga N.SH. "PAN Engineering" nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70325126;
- "Deklarata-Pëlqimi" Nr.8076/2017 me datë 31.10.2017, sipas të cilit, z.Sabri Xylfiu, z.Shemsi Lushaku dhe Bujar Mersini, në cilësinë e pronarëve të parcelave kadastrale nr.90-1, 90-2 dhe 90-3, japin pëlqim të parevokueshëm që z.Feti Selmani, të ndërtojë pa asnjë pengesë në ngastrat kadastrale nr.110-3 dhe 155-19, në përputhje me zgjidhjen e tij urbane;
- Vërtetimet mbi obligimet tatimore, lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit-letërnjoftimit të pronarit, autorizuesit dhe investitorit;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr.350/02-0051312 dt.02.03.2018, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, plotësimit të dokumentacionit shtesë me dt.19.03.2018, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni (Plani Rregullues "Sofalia" 2016-2024), rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 12 dhe 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", ka konstatuar se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacionit -"zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregullues dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Sofalia" 2016-2024 në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualet gjeodezike për këmbim dhe ndarje/bashkim.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dërgohet:** Kërkuesit/ve, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**
**05 NR. 350/02-0051312/18 DT. 24.04.2018**

| Punoi, | Kontrolloi, | **DREJTORI,** |
|---|---|---|
| Krenare Shkodra | Nazife Krasniqi | Ardian Olluri |



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net




ISPN - indeksi ndertimor i lejuar 0.8 X 500 m2 = 400 m2
ISPN e propoz. te parcela me 500 m2 = 261 m2

ISPN - indeksi ndertimor i lejuar 0.8 X 825 m2 = 660 m2
ISPN e propoz. te parcela me 825 m2 = 281 m2

ISP - shputa e lejuar 0.3 X 400 m2 = 120 m2
ISP - shputa e propoz. me 0.33
(me e vogel se 0.4 sipas vendimit te kryetarit)
te 2 parcelat me 400 m2 = 130 m2 per te bere
projekt zbatues per rritje te eficences se energjise

ISP - shputa e lejuar 0.3 X 500 m2 = 150 m2
ISP - shputa e propoz. te parcela me 500 m2 = 130 m2

ISP - shputa e lejuar 0.3 X 825 m2 = 660 m2
ISP - shputa e propoz. te parcela me 825 m2 = 130 m2

ISN - indeksi i lejuar i shfrytezimit te nentokes = 0.5
ISN e propozuar me 81 m2 bodrum eshte nen vleren 0.5

ISGJ - Indeksi minimal i gjelberimit = 0.5
ISGJ e propozuar ne parcelat me madhesi te ndryshme eshte dukshëm me i madh se vlera 0.5 (shih vizualizimet ne 3D)

Me këtë ide konceptuale si pronar i parcelave në fjalë propozoj marrëveshje me Komunën për këmbimin e pronës time private me pronën publike në atë formë për tiu përshtatur Planit rregullues në fuqi për Sofalinë dhe idesë time për zhvillim të pronës. (Shih në këtë vizatim të planvendosjes ndikimin e Planit rregullues në pronën time private)

| DIZAINI ARKITEKTURAL KONCEPTUAL | | |
|---|---|---|
| NDËRTESË BANIMI | 4 SHTËPI NJË FAMILIARE | |
| VENDI I NDËRTIMIT | SEFALI, PRISHTINË | |
| PRONAR | FETI SELMANI | |
| DIZAJNOI: D. K. ARK. I DIP. | | |
| DATA: SHKURT 2018 | FORMATI I LETRËS A3 | VIZATIMI ARK. |
| Tema dhe shkalla e vizatimit: Planvendosja sipas dizajn propozimit per shtepite dhe ndarjen e 2 parcelave ne 4 parcela 1 : 500 | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina

DREJTORIA E URBANIZMIT

# SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01




| Vija Rregulluese sipas PRRU | | |
|---|---|---|
| 1 | 7516316.44 | 4725694.63 |
| 2 | 7516343.69 | 4725719.64 |
| 3 | 7516339.29 | 4725723.34 |
| 4 | 7516333.83 | 4725728.58 |
| 5 | 7516328.71 | 4725733.82 |
| 6 | 7516322.98 | 4725740.25 |
| 7 | 7516317.86 | 4725747.19 |
| 8 | 7516311.98 | 4725755.98 |
| 9 | 7516309.25 | 4725758.28 |
| 10 | 7516307.61 | 4725759.11 |
| 11 | 7516305.86 | 4725759.68 |
| 12 | 7516303.98 | 4725759.98 |
| 13 | 7516301.89 | 4725760.06 |
| 14 | 7516299.29 | 4725760.58 |
| 15 | 7516296.81 | 4725761.51 |
| 16 | 7516294.51 | 4725762.81 |
| 17 | 7516292.44 | 4725764.46 |
| 18 | 7516290.74 | 4725766.32 |
| 19 | 7516282.01 | 4725778.01 |
| 20 | 7516279.08 | 4725781.46 |
| 21 | 7516276.57 | 4725783.91 |
| 22 | 7516275.32 | 4725785.10 |
| 23 | 7516274.55 | 4725785.79 |
| 24 | 7516273.94 | 4725786.11 |
| 25 | 7516273.05 | 4725786.00 |
| 26 | 7516272.41 | 4725785.36 |
| 27 | 7516272.29 | 4725784.69 |
| 28 | 7516272.40 | 4725784.24 |
| 29 | 7516272.90 | 4725783.09 |
| 30 | 7516293.10 | 4725736.78 |
| 31 | 7516295.99 | 4725731.00 |
| 32 | 7516299.27 | 4725725.34 |
| 33 | 7516304.85 | 4725716.33 |
| 34 | 7516310.45 | 4725706.65 |
| 35 | 7516315.10 | 4725697.95 |

| Vija Ndërtimore sipas PRRU | | |
|---|---|---|
| 36 | 7516322.40 | 4725693.21 |
| 37 | 7516319.65 | 4725700.04 |
| 38 | 7516316.32 | 4725706.48 |
| 39 | 7516314.78 | 4725709.15 |
| 40 | 7516309.14 | 4725718.90 |
| 41 | 7516303.56 | 4725727.91 |
| 42 | 7516300.40 | 4725733.38 |
| 43 | 7516297.63 | 4725738.90 |
| 44 | 7516287.22 | 4725762.76 |
| 45 | 7516289.02 | 4725760.80 |
| 46 | 7516291.71 | 4725758.65 |
| 47 | 7516294.70 | 4725756.96 |
| 48 | 7516297.92 | 4725755.76 |
| 49 | 7516301.29 | 4725755.08 |
| 50 | 7516304.69 | 4725754.80 |
| 51 | 7516306.64 | 4725753.99 |
| 52 | 7516308.10 | 4725752.78 |
| 53 | 7516313.77 | 4725744.31 |
| 54 | 7516319.09 | 4725737.10 |
| 55 | 7516325.06 | 4725730.41 |
| 56 | 7516330.31 | 4725725.02 |
| 57 | 7516335.94 | 4725719.62 |
| 58 | 7516342.03 | 4725714.50 |

Punoi:
Kushtrim Domaneku______________

Prishtinë 24.04.2018

**Legjenda:**

- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: PRISHTINË
Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 110-3 dhe118-0

Zona kadastrale / Katastarska zona: SOFALI
Numri i lëndës / Broj predmeta: /2018

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë
Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000

| ParcelA 118-0 pjese | | |
|---|---|---|
| 1 | 7516325.993 | 4725697.724 |
| 2 | 7516301.355 | 4725756.104 |
| 3 | 7516300.391 | 4725757.772 |
| 4 | 7516299.453 | 4725760.551 |
| 5 | 7516296.814 | 4725761.506 |
| 6 | 7516295.01 | 4725762.527 |
| 7 | 7516298.978 | 4725756.37 |
| 8 | 7516313.542 | 4725722.06 |
| 9 | 7516324.125 | 4725697.129 |
| **Parcela 110-3 pjese** | | |
| 10 | 7516315.58 | 4725694.408 |
| 11 | 7516309.876 | 4725706.931 |
| 12 | 7516299.607 | 4725723.028 |
| 13 | 7516291.337 | 4725735.437 |
| 14 | 7516286.601 | 4725743.764 |
| 15 | 7516280.037 | 4725758.816 |
| 16 | 7516270.938 | 4725779.665 |
| 17 | 7516264.451 | 4725797.631 |
| 18 | 7516261.635 | 4725802.313 |
| 19 | 7516258.325 | 4725805.586 |
| 20 | 7516263.407 | 4725797.135 |
| 21 | 7516269.869 | 4725779.239 |
| 22 | 7516278.982 | 4725758.359 |
| 23 | 7516285.499 | 4725743.225 |
| 24 | 7516290.36 | 4725734.829 |
| 25 | 7516298.644 | 4725722.4 |
| 26 | 7516308.863 | 4725706.381 |
| 27 | 7516314.461 | 4725694.051 |

Propozim për zhvendosje të pjesës të parcelës 118-0, në pjesën perëndimore, në afërsi të rrugës 806-0 përgjat parcelës P-110-3 me mundësi të realizimit dhe krijimit të parcelave të parapara me plan rregullues Sofalia 2016.
Pjesa e parcelës 118-0 e cila zhvendoset, ka S=143m2, dhe në llogari të parcelës P-110-3 të zbritet sipërfaqja S=143m2
Pozicioni i pjesës së parcelës pjesë 118-0 është i përshkruar me pika detale duke filluar nga pika nr.1 deri te pika nr.9 me kordinata.
Pozicioni i parcelës pjesë 118-0 do të vendoset në parcelën 110-3 e cila është përshkruar me pika detale duke filluar prej pikës nr.10 deri te pika nr 27 të përcaktuara me kordinata.




Rilevoi / Snimio: Ing. i gjeode. Veli Hyseni
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio:
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime službenog lica)

Nr. i licences / Br. licence:

Nënshkrimi / Potpis:

Nenshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 14.03.2018

Rgjistri i fleteparaqitjeve/ S. prijava

GJEODETI I LICENCUAR - LICENCIRANI GEODETA
Veli H.Hyseni
V.V.
PRISHTINË-PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: PRISHTINË    Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 110-3, 155-19 dhe118-0

Zona kadastrale / Katastarska zona: SOFALI    Numri i lëndës / Broj predmeta: /2018

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë    Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000

| | | |
|---|---|---|
| 1 | 7516258.325 | 4725805.586 |
| 2 | 7516261.635 | 4725802.313 |
| 3 | 7516282.96 | 4725781.226 |
| 4 | 7516295.01 | 4725762.527 |
| 5 | 7516296.814 | 4725761.506 |
| 6 | 7516299.453 | 4725760.551 |
| 7 | 7516300.391 | 4725757.772 |
| 8 | 7516303.711 | 4725759.127 |
| 9 | 7516304.723 | 4725760.409 |
| 10 | 7516305.06 | 4725762.229 |
| 11 | 7516311.264 | 4725756.497 |
| 12 | 7516317.573 | 4725747.243 |
| 13 | 7516322.391 | 4725740.177 |
| 14 | 7516326.441 | 4725736.112 |
| 15 | 7516335.704 | 4725726.816 |
| 16 | 7516341.138 | 4725721.362 |
| 17 | 7516343.663 | 4725719.607 |
| 18 | 7516329.008 | 4725698.681 |
| 19 | 7516325.993 | 4725697.724 |
| 20 | 7516319.336 | 4725713.497 |
| 21 | 7516314.048 | 4725726.027 |
| 22 | 7516308.285 | 4725739.684 |
| 23 | 7516301.355 | 4725756.104 |
| 24 | 7516298.978 | 4725756.37 |
| 25 | 7516315.546 | 4725694.482 |
| 26 | 7516310.252 | 4725706.105 |
| 27 | 7516309.876 | 4725706.931 |
| 28 | 7516303.283 | 4725717.267 |
| 29 | 7516295.461 | 4725729.249 |
| 30 | 7516291.337 | 4725735.437 |
| 31 | 7516286.601 | 4725743.764 |
| 32 | 7516280.037 | 4725758.816 |
| 33 | 7516270.938 | 4725779.665 |
| 34 | 7516264.451 | 4725797.631 |
| 35 | 7516263.407 | 4725797.135 |
| 36 | 7516269.869 | 4725779.239 |
| 37 | 7516278.982 | 4725758.359 |
| 38 | 7516285.499 | 4725743.225 |
| 39 | 7516290.36 | 4725734.829 |
| 40 | 7516298.644 | 4725722.4 |
| 41 | 7516308.863 | 4725706.381 |
| 42 | 7516314.422 | 4725694.125 |

Propozim për parcelizim dhe rregullim të pjesës së parceles 118-0




Rilevoi / Snimio: Ing. gjeod. Muzafer Mustafa
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: ____________
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 09

Nënshkrimi / Potpis: ____________

Nënshkrimi / Potpis: ____________

Data e aprovimit / Datum usvajanja: ____________

Data e rilevimit / Datum snimanja: 17.04.2018

Rgjistri i fleteparaqitjeve/ S. prijava ____________

GJEODET I LICENCUAR - LICENCIRANI GEODETA
MUZAFER K. MUSTAFA
PRISHTINË-PRISTINA

## Zona Kadastrale Sofali

Parcela Kadastrale nr.118-0 sip.1501 m2, Pasuri.Shoqrore.
Kuvendi Komunal Prishtinë
Parcela Kadastrale nr.110-3 sip.1507 m2 kultura arë e klasës 4
Bashkpronarët: Feti (Halil) Selmani 2/4,
Haki (Halil) Selmani 1/4,
Isa (Halil) Selmani 1/4,
Pjesa e parcelës nr.118-0 me sip.143 m2, e cila është propozuar për këmbim me pjesën e parcelës 110-3 me sip.143 m2.në bazë të Vendimit për caktimin e kushtëve ndërtimore 05 NR. 350/02-0051312/18 të datës 24.04.2018, nga Drejtoria e Urbanizmit, dhe kërkesës nr.13-463/03-0131372/18.




– Prona Private.

– P.Sh.K.K. Prishtinë

Punoi: Adnan Berisha zyrtar i lartë për gjeodezi

Prishtinë
26.06.2018

**Adnan.k.Berisha**

| | |
|---|---|
| **From:** | Florim A. Krasniqi |
| **Sent:** | Tuesday, July 03, 2018 9:35 AM |
| **To:** | Adnan.k.Berisha |
| **Cc:** | Burbuqe Hydaverdi; Genc Bashota; Dren Kukaj; Zoja Hasimi |
| **Subject:** | Re: Kërkes |
| **Attachments:** | 07 Kushtet e Rregullimit-Model.pdf |

Pershendetje Adnan,

Ne lidhje me kerkesen tuaj ju informojme se parcelat e poshte shenuara shtrihen brenda Planit Rregullues te Hollesishem "Sofali" ku ne baze te keti plani ju informojme se parcela prone private me ngjyre te verdh shtrihet ne Infrastruktur Rrugore te Planifikuara ndersa parcela / prona PSH.K.K-Prishtine shtrihet ne zone te planifikuar per banim Individual.

Bashkangjitur keni pjesen grafike nga Plani Rregullues Sofalia.

gjitha te mirat.

Florim Krasniqi
Zyrtar i Lartë për Planifikim
**Drejtoria e planifikimit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm -Sektori për Planifikim**

**Komuna e Prishtinës**

e-mail: florim.a.krasniqi@rks-gov.net
tel: 038 223 691
mob: 044 600 348

---

**From:** Adnan.k.Berisha
**Sent:** Tuesday, June 26, 2018 12:16 PM
**To:** Florim A. Krasniqi
**Cc:** Fidan Thaci
**Subject:** Kërkes

Përshëndetje,

Drejtoria e pronës, e ka pranuar kërkesën me nr. 13/463/03-0131372/18, të paraqitur nga Feti Selmani, ku është kërkuar këmbimin i pronës komunale, parcela nr.118-0, me atë private nr. 110-3, zona kadastrale Sofali. Kërkojmë nga Drejtoria e planifikimit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm, që të na dërgoni destinimin për parcelat nr.118-0 dhe 110-3 zona kadastrale Sofali.

Në attach gjeni të bashkangjitur skicën e propozuar për këmbim

**Adnan Berisha**
Zyrtar i Lartë për gjeodezi

Drejtoria e Pronës
Komuna e Prishtinës

e-mail: adnan.berisha@rks-gov.net
tel: +381 (0) 38 223 665
lok: 153
VoIP: 40076
mob: +377 (0) 44 550 548



## Fidan Thaci

**From:** Ergyn Hajredini
**Sent:** Friday, June 22, 2018 2:41 PM
**To:** Fidan Thaci
**Cc:** Xhevdet Zani
**Subject:** RE: Informatë

Fidan bazuar në Manualin e këmbimit pjesët e parcelave me sipërfaqe janë : pjesa e parcelës kadastrale nr.118-0 ZK Sofali me pronar P.SH. KK Prishtinë me sipërfaqe prej S=143m2, ku këmbehet me pjesën e parcelës kadastrale nr.110-3 ZK Sofali me pronar Isa, Feti Selmani dhe Ismajl Abazi , me sipërfaqe prej S=143m2.

**From:** Fidan Thaci
**Sent:** Friday, June 22, 2018 2:24 PM
**To:** Ergyn Hajredini
**Cc:** Xhevdet Zani
**Subject:** Kerkes

Përshëndetje,

Drejtoria e Pronës, e ka pranuar kërkesën me nr.13-463/03-0131372/18,nga Feti Selmani Prishtinë, lidhur me këmbimin e pjesëve të parcelave nr.110-3 dhe 118-0 Z.K Sofali.

Andaj për zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit, që të specifikohet sipërfaqet e këmbimit në Vendimin për Caktimin e Kushteve Ndërtimore, ku është dhënë Pëlqimi për Këmbimin e pjesëve të parcelave të lartcekura nga Drejtoria e Urbanizmit.

**Shtojcë:**
Në attach e gjeni të bashkangjitur Vendimin për Caktimin e Kushteve Ndërtimore

Me respekt
Fidani

Fidan Thaçi
Zyrtar i lartë për çështje pronësore
Drejtoria e Pronës
Komuna e Prishtinës

e-mail: fidan.thaci@rks-gov.net
tel: +381 (0) 38 223 665
lok: 153
mob: +377 (0) 44 333 303